



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 9, datë 27.02.2014

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PËR EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT “ANSIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare“, të nenit 62 dhe 63, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime“, si dhe të Rregullores nr. 14, datë 08.02.2007 “Për disa kritere që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit“, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Dhënien e miratimit për emërimin e Znj. Fatbardha Zhabjaku, në funksionin e administratorit të shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI